



**REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO**

**KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS  
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA/ KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL**



**RAPORT TREMUJOR**

**(janar – mars 2024)**

**PËR AKTIVITETET DHE REKOMANDIMET E KOORDINATORIT  
KOMBËTAR PËR LUFTIMIN E KRIMIT EKONOMIK**

**Prishtinë, maj 2024**

## **1. HYRJE – Mandati i Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik**

Pozita e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik është krijuar në bazë të një udhëzimi administrativ të lëshuar nga kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) me 27 dhjetor 2013. Personi i emëruar për atë pozitë ka kompetenca dhe përgjegjësi për detyrat në vijim:

1. Koordinimin e aktiviteteve për rritje të vetëdijesimit të të gjitha agjencioneve të përfaqësuara nga nënshkruesit e këtij memorandumi, përmes mediave publike dhe mënyrave tjera, për rreziqet që shoqërohen me dështim dhe benefitet e suksesit të luftimit të krimeve që gjenerojnë dobi pasurore;
2. Mbikëqyrjen e krijimit dhe implementimit të planeve të veprimit, të dizajnuara për të arritur dhe për të mirëmbajtur përputhjen me standardet ndërkombëtare kundër pastrimit të parasë;
3. Koordinimin e reagimit kombëtar ndaj kërkesave të organizatave ndërkombëtare për zhvillim të ekzaminimeve ose vlerësimeve kundër pastrimit të parasë;
4. Mbikëqyrjen e planifikimit dhe implementimit të programeve të trajnimit të përfshira në mandatin e Institutit kundër Krimit Ekonomik (IKE);
5. Identifikimin e mundësive për përmirësim, praktika më të mira dhe procedura operuese që mund të përmirësojnë efikasitetin dhe efektivitetin e programit dhe komunikimin e kësaj informate tek autoritetet e përshtatshme;
6. Grumbullimin dhe analizimin e informatave në lidhje me efikasitetin dhe efektivitetin e entiteteve të involvuara në luftimin e krimeve që gjenerojnë dobi pasurore dhe raportimin e këtyre informatave tek autoritetet e përshtatshme;
7. Sigurimin e mbështetjes administrative dhe funksionale për arritjen e objektivave të strategjive kombëtare për luftimin e pastrimit të parasë, financimit të terrorizmit dhe ekonomisë joformale;
8. Rekomandimin e modifikimeve në strategji kombëtare ose legjislacion që do të përmirësonte përputhjen me standardet ndërkombëtare kundër pastrimit të parasë ose rritjen e efikasitetit apo efektivitetit të programit,
9. Koordinatori Kombëtar do të monitorojë punën e të gjitha institucioneve relevante në R. e Kosovës lidhur me procesimin e rasteve që hyjnë në kuadër të kësaj rregulloreje dhe memorandumit të bashkëpunimit;
10. Koordinatori Kombëtar do të monitorojë dhe do të përcjellë procedimin e rasteve nga institucioni në institucion;
11. Koordinatori mund të propozojë udhëzime për institucionet në fjalë se si të përmirësojnë nivelin e performancës dhe raportimit.
12. Koordinatori Kombëtar ka rol të rëndësishëm në dokumentin e aprovuar nga KPK mbi “Procedurat Standarde të Veprimit për përzgjedhjen e shënjestrave të krimeve të rënda dhe bashkëpunimi ndërinstitutional”;

13. Koordinator Kombëtar po ashtu ka rol edhe në dokumentin tjetër strategjik të aprovuar nga Qeveria e R. së Kosovës “Strategjia Kombëtare e Republikës së Kosovës për parandalimin dhe luftimin e ekonomisë joformale, pastrimin e parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve financiare 2014-2018”.

Prokurori Shqipdon Fazliu, është caktuar nga KPK-ja për këtë pozitë. Ky raport do të bëjë të ditura aktivitetet e tij dhe të entiteteve të involvuara në tri shtyllat e programit të tij: parandalimi dhe detektimi, trajnimi dhe luftimi i krimit ekonomik.

## **2. ANALIZA&SUKSESET**

Periodha e tremujorit të parë e vitit 2024, janar – mars, sjellë rezultate shumë të mira. Kështu, tremujori i parë i vitit 2024 e gjen sistemin e drejtësisë me 32,146,654.82 € ngrirje/sekuestrim dhe me 1,811,669.70 € konfiskim, në dy raste të raportuara.

Ajo që mund të konstatohet pa dyshim, është se ka vazhduar edhe në tremujorin e parë, trendi pozitiv i arritur në vitin 2023, ngase përpos një shifre impresive të sekuestrimit, kemi edhe rezultat shumë të mirë në sferën e konfiskimit, duke pasur 2 raste në një tremujor të vetëm.

Është më rëndësi të nënvizohet se rasti i dytë me konfiskim, pra rasti i Mitrovicës (PP.I.nr.69/2021) ka marrë formën e prerë në fund të vitit 2022, por që nuk është raportuar vetëm tani.

### **RASTET E KONFISKIMIT:**

1. Kështu, rasti i parë evidentohet nën shifrat PP.II.nr.8885/14, i datës 30.10.2017, për shkak të veprës penale, legalizimi i përmbajtjes së rreme, nga neni 403 paragrafi 2 i KPRK-së (prokurorja e rastit Rukije Shasivari). Në këtë rast kemi një të pandehur Sh. Q., ku prokurorja e rastit kishte ngritur aktakuzën dhe kishte propozuar konfiskimin e pronës së paluajtshme që gjendet në Prishtinë, në sipërfaqe prej 1497 m<sup>2</sup>.

Në gjykatë evidentohet rasti nën shifrat e Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.1631/2020, i datës 21.12.2022 dhe numri SMIL 2019:129056. Gjykata me këtë rast ka marrë aktgjykim dënues dhe të dënuarit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vite, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 2 vite nuk kryen vepër tjetër penale.

Ndërsa ka vendosur të konfiskoj aktgjykimin AC.nr.128/83, i dt. 10.05.1983 dhe konfiskimin e pronës së paluajtshme në Prishtinë, në sipërfaqe prej 4197 m<sup>2</sup>.

Gjykata e Apelit me aktgjykimin PA1.nr.176/23, i datës 07.04.2023, ka refuzuar ankesat e mbrojtësit të të dënuarit dhe ka lënë në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë.

Krejt në fund, edhe Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin Pml.nr.449/2023, të datës 17.01.2024, kishte marrë aktgjykim me të cilin ka refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga ana e mbrojtësit të të dënuarit.

2. Rasti i dytë evidentohet nën shifrat PP.I.nr.69/2021, i datës 06.05.2021 (PTH Mitrovica, DKR), për shkak të veprave penale, blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267.1 të KPRK-së, pengimi i të provuarit apo procedurës zyrtare nga neni 386.2 të KPRK-së (prokurori i rastit Njazi Rexha). Në këtë rast kemi dy të pandehur, N.P dhe A.C., ku prokurori i rastit kishte ngritur aktakuzën dhe kishte propozuar konfiskimin e parave të gjetura tek të pandehurit.

Në gjykatë evidentohet rasti nën shifrat e Gjykatës Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.77/2021, i datës 14.01.2022 dhe numri SMIL 2021:028010. Gjykata me këtë rast ka marrë aktgjykim dënues dhe të dënuarit i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 vite e 6 muaj dhe dënim me gjobë prej 2000 €, ndërsa të pandehurit të dytë i ka shqiptuar dënim me gjobë prej 1000 €.

Ndërsa, në bazë të nenit 92.1 të KPRK-së dhe në bazë të nenit 284.1 të KPP-së (Bëhet fjalë për nenin që flet për gjyqtarët zëvendësues), ka vendosur të konfiskoj paratë në shumën prej 132,869.70 €.

Gjykata e Apelit me aktgjykimin PA1.nr.84/22, i datës 04.05.2022, ka refuzuar ankesat e mbrojtëseve të të pandehurve dhe të prokurorisë dhe ka lënë në fuqi aktgjykimin e shkallës së parë.

Gjykata Supreme e Kosovës, me aktgjykimin Pml.nr.462/2022, të datës 12.12.2022, kishte marrë aktgjykim me të cilin ka refuzuar kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë të parashtruar nga ana e mbrojtësit të të dënuarit.

Mbetet fakt pozitiv e dhëna se ky tremujor e gjen sistemin e drejtësisë me 2 raste të raportuara me konfiskim final dhe në të dy rastet bëhet fjalë për raste të mëdha. Përderisa, në njërin rast bëhet fjalë për një pronë të paluajtshme në Prishtinë, në rastin e dytë bëhet fjalë për një shumë relativisht të madhe të parave të gatshme, para këto që janë derdhur në buxhetin e vendit.

Këto rezultate, kombinuar edhe me trendin e vitit të kaluar, mund të jetë një indikator se zbatimi i dispozitave të konfiskimit ka filluar të rritet dhe të kuptohet më mirë. Në rastin e Mitrovicës, konfiskimi i shumës prej mbi 130,000 € është bërë bazuar në nenin 92 të KPRK-së, e për të cilin nen, ne sa e sa herë, në raportimet para KPK-së, kemi propozuar që të zbatohet më shumë.

Sidoqoftë, në anën tjetër, neni 92 pavarësisht zbatimit në këtë rast, nuk kemi të dhëna se po zbatohet sa duhet. Një zbatim konsistent i këtyre dispozitave është parakusht për arritjen e objektivave reale që do të duhej të plotësoheshin në kuptim të rritjes së shifrave të konfiskimit.

Edhe shitja e aseteve të sekuestruara vazhdon të jetë e ulët pavarësisht progresit që ekziston në këtë drejtim.

Ajo që mund të veçojmë si pozitive gjatë kësaj periudhe tremujore është fakti se konfiskimet, ngrirjet dhe sekuestrimet kanë ndodhur për vepra të ndryshme penale, duke përfshirë vepra penale kundër korrupsionit (keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar), krimeve ekonomike (ndër tjera edhe për shpëlarjen e parave), veprat penale kundër narkotikëve, armëve, grabitje, falsifikimi i dokumentit, vrasjes, etj..

Më pas është edhe një fakt tjetër pozitiv që tregohet përmes faktit se 37 prokurorë në 63 raste janë përfshirë në sekuestrim, ngrirje dhe konfiskim të pasurisë në raste të ndryshme.

-Trendi i zgjidhjes së rasteve të krimeve ekonomike në raport me ato të pranuar gjatë tremujorit të parë të vitit 2024, është negativ në raport me rastet dhe pozitiv në raport me persona. Kështu, të dhënat statistikore dëshmojnë se këtë tremujor janë pranuar gjithsej 77 raste të reja me 87 persona, ndërsa që janë zgjidhur 73 raste me 105 persona. Edhe më saktë, duke përdorur përqindjen, del se prokuroritë kanë zgjidhur 94.80% të rasteve të pranuar dhe 120.68% të rasteve me persona gjatë TM1 të vitit 2024.

-Më tutje, përderisa jemi ende te kjo çështje, është interesante të shihet se nga totali prej 105 rasteve të zgjidhura me persona në TM1, prokuroritë themelore dhe PSRK, së bashku, kanë vendosur të ngrisin aktakuza kundër 83 personave, apo në 79%, ndërsa kanë vendosur të pushojnë hetimet kundër 10 personave apo në 10% të tyre si dhe kanë hedhur kallëzimet penale kundër 12 personave apo në 11% të tyre.

- Te vepra penale e shpëlarjes së parave në TM1 të vitit 2024 kemi pasur 6 kallëzime penale të reja të pranuar kundër 16 personave, ndërsa që janë zgjidhur 0 raste me 0 persona. Pra, sikur që vërehet, PSRK ka zgjidhur më pak raste se sa janë pranuar sa u përket kallëzimeve penale, si me raste ashtu edhe me persona.

-Ndërsa, kur jemi te vendimet e gjykatave paraqitet një situatë pozitive ngase kemi 17 vendime nga ana e gjykatës. Nga numri prej 17 personave, gjykatat kanë marrë aktgjykime fajësuese kundër 13 personave, në 0 raste është hedhur aktakuza para shqyrtimit gjyqësor, në 3 raste të akuzuarit janë liruar nga aktakuzat dhe në 1 rast është refuzuar aktakuza. Pra, nga totali prej 17 vendimeve për persona, në 76.47% të tyre gjykatat kanë shpallur personat fajtor sipas aktakuzave, në 00% të rasteve janë hedhur aktakuzat para shqyrtimit gjyqësor, në 17.64% të rasteve të akuzuarit janë liruar nga akuzat dhe në 5.88% është refuzuar aktakuza.

### **3. KONSTATIMET**

Periodha që përfshin tremujorin e parë të vitit 2024 paraqet një rezultat të mirë. Këtë e pasqyron fakti se ka dy raste me konfiskim final, me shumën prej 1,811,669.70. Ndërsa, shuma e sekuestrimeve apo ngrirjeve në TM1 kap vlerat 32,146,654.82 € ngrirje/sekuestrim.

Progres mund të konsiderohet edhe fakti se tashmë, përpos vitit 2023, që ishte vit mëse i suksesshëm, duket se edhe ky vit është në trend të ngjashëm, ngase shifra e konfiskimit tashmë thuhet se ka arritur në 2 milion euro, që edhe nëse shifrat mbesin vetëm me këtë tremujor, sërish përbën një ndër vitet më të mira me rezultat sa i përket konfiskimit final.

Në anën tjetër, Gjykata Supreme e Kosovës, ka marrë një aktgjykim në një rast që ka të bëjë me shpëlarjen e parave dhe nëse rasti në fjalë mbetet në fuqi, do të ndryshoj gjitha mënyrën e trajtimit të kësaj vepre penale, trajnimet e kryera dhe shumë aspekte tjera. Rasti i tillë është trajtuar nga ne dhe në periudhën e ardhshme besojmë se mund të japim më shumë informacione.

### **4. LIGJI MBI KOMPETENCAT E ZGJERUARA TË KONFISKIMIT**

LKZK e re ka hyrë në fuqi në janar të vitit 2019. Çdo aktgjykim që merret pas datës së hyrjes në fuqi, ka mundësi që LKZK e re të aplikohet dhe kjo paraqet një mundësi të mirë për sistemin gjyqësor të vendit që shifrat e konfiskimeve t'i rrisë duke shfrytëzuar këtë ligj që është shumë më i fuqishëm se sa ai i kaluari.

Kështu, PTH Peja, ka 4 raste në proces e sipër sipas këtij ligji.

Në rastin PP.I.nr.250/22, është ngritur tashmë aktakuza e dt. 14.12.2022, kundër të pandehurit N. I., për shkak të dyshimit se është kryer vepra penale e blerjes, posedimit, shpërndarjes dhe shitjes së pautorizuar të narkotikëve nga neni 267.2 i KPRK-së. Me dt. 20.12.2022, është iniciuar hetimi për konfiskimin, ndërsa me dt.

22.12.2022, është lëshuar Urdhi Kufizues i Përkohshëm për një lokal prej 79m<sup>2</sup>. Me dt. 28.12.2022, është parashtruar kërkesa për lëshimin e Urdhit Kufizues Përfundimtar.

Në rastin tjetër, PP.II.nr.1927/19, ka pasur disa zhvillime, ku fillimisht është refuzuar kërkesa e prokurorisë për zbulim të disa akteve e që pas ankesës së prokurorisë, Gjykata e Apelit ka aprovuar pjesërisht kërkesën e prokurorisë.

Katër rastet e PTH Pejës janë nën shifrat:

PP/I nr. 250/22;

PP/I nr. 1927/19;

PP/I nr. 589/21; dhe

PP/I nr. 230/21.

**Nuk ka asgjë të re për të raportuar në TM1.**

## **RAPORT TREMUJOR**

**janar – mars 2024**

### **5. BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

#### **Legjislacioni:**

- Është aprovuar në bordin ekzekutiv të BQK -s Manuali i Mbikëqyrjes së Bazuar në Rrezik për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Luftimit të Financimit të Terrorizmit.

#### **Operacionet:**

Banka Qendrore e Kosovës gjatë kësaj periudhe raportuese ka kryer 3 ekzaminime në fushën PPP/FT në institucionet financiare si në vijim:

1. BKT Kosovë;
2. Pribank;
3. IFJB Ibas;

#### **Bashkëpunimi dhe trajnimet:**

- Pjesëmarrja në kolegjin e mbikëqyrësve për PPP/LFT të NLB Grup;
- Pjesëmarrja në Grupin Punues Ndërinstitucional për Koordinimin e Zbatimit të Sanksioneve;
- Pjesëmarrje në Prezentimin e Metodologjisë së Këshillit të Evropës lidhur me Vlerësimin e Rrezikut për Pastrimin e Parave dhe Financimin e Terrorizmit (VKRr PP/FT);
- Pjesëmarrja në takimin e përfaqësuesit/ekspertit të projektit të ambasadës së MB-së dhe NJIF-K;
- Punëtorja për sanksionet dhe fuqizimin e kontrollit gjatë procesit të eksportit.

## 6. NJËSIA E INTELIGJENCËS FINANCIARE

NJIF do të raportojë periudhën e ardhshme.

## 7. POLICIA E KOSOVËS

Policia e Kosovës ka raportuar se gjatë këtij tremujori të parë ka pasur këto aktivitete të trajnimit:

| Nr. | Trajnim, Punëtori, Konferenc, Takim etj. të organizuara nga organizata tjera             | Organizator                                                                              | Nr. trajnimeve | Nr. Pjesmarre sve |
|-----|------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------|----------------|-------------------|
| 1   | Trajnim Hetimi Financiar dhe Rikuperimi i Aseteve                                        | Akademia e Drejtësisë                                                                    | 1              | 4                 |
| 2   | Punëtorja Siguria kibernetike regjistrimi i Popullsisë 2024                              | Agjencia e Statistikave të Kosovës                                                       | 1              | 2                 |
| 3   | Punëtori për Procesin e Deklarimit të Pasurisë përmes sistemit elektronik                | Agjensioni kundër korrupsionit                                                           | 1              | 1                 |
| 4   | Trajnim i avancuar për Hetimin financiar                                                 | GIZI                                                                                     | 1              | 5                 |
| 5   | Trajnim Korrupsioni ne nivel qeveritare dhe analizat financiare                          | ICITAP                                                                                   | 1              | 24                |
| 6   | Trajnim për Trajner” (ToT) Kundër Financimit të Terrorizmit moduli i radhës (IV)         | Austria OSBE                                                                             | 1              | 2                 |
| 7   | Takim pune për krimet financiare, pastrimin e parave dhe rikthimin e asetave             | Holanda GIZI                                                                             | 1              | 1                 |
| 8   | Trajnim për luftimin e krimit të organizuar ndërkombëtar                                 | Italia CASERTA                                                                           | 1              | 1                 |
| 9   | Vizitë studimore (në fushën e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit)          | Italia Projekti KOS 18-0005 - Mbështetje për Procesin e Integritetit Evropian të Kosovës | 1              | 2                 |
| 10  | Trajnim Luftimi i Terrorizmit dhe Subversionit                                           | Italia Qendra ndërkombëtare e trajnimeve të avancuara Caserta                            | 1              | 1                 |
| 11  | Trajnim Luftimi i krimit të organizuar ndërkombëtar                                      | Italia Qendra ndërkombëtare e trajnimeve të avancuara Caserta                            | 1              | 1                 |
| 12  | Trajnim Luftimi i Krimit Kibernetik                                                      | Italia Qendra ndërkombëtare e trajnimeve të avancuara Caserta                            | 1              | 1                 |
| 13  | Trajnim Luftimi i Trafikimit me Njerëz dhe Kontrabandimi me Migrant                      | Italia Qendra ndërkombëtare e trajnimeve të avancuara Caserta                            | 1              | 1                 |
| 14  | Punëtori Krimi i Organizuar Ndërkombëtar dhe Korrupsioni në Kontekstin e Krimit Mjedisor | Kroaci Ambasadën Amerikane                                                               | 1              | 1                 |

|               |                                                                                      |                                                             |           |           |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------|-----------|-----------|
| 15            | Trajnim Krimi i Organizuar Mjedisor dhe Korrupsioni                                  | Kroaci<br>ICITAP                                            | 1         | 1         |
| 16            | Trajnim Rreziqet e korrupsionit dhe pastrimit të parave që lidhen me krimin mjedisor | Shqipëria<br>Këshilli i Evropës -Divizioni i<br>Strasburgut | 1         | 1         |
| <b>totali</b> |                                                                                      |                                                             | <b>16</b> | <b>49</b> |

## 8. STATISTIKAT E NGRIRJEVE, SEKUESTRIMEVE DHE KONFISKIMEVE

### Ngrirjet, sekuestrimet, dhe konfiskimet për tremujorin e parë për vitin 2024

Gjatë periudhës raportuese të tremujorit të parë (janar-mars) për vitin 2024 janë sekuestruar si në vijim:

- 48 automjete .....235,631.04 €
- 1 shtëpi, 3 apartamente, 1 garazhë.....891,500.00 €
- 12 parcela .....30,488,475.00 €
- Eskavator, Separacion.....52,000.00 €
- Para .....329.587.06 €
- Të tjera (pajisje teknologjike, pajisje mjekësore dhe shtëpiak, masë drunore, mallra të ndryshme veshëmbathje) etj.).....149,461.72 €.

**Sekuestrime janë:** 32,146,654.82 €

**Konfiskimi:** 1,811,669.70 €.

**Totali i konfiskimit, sekuestrimit, ngrirjes 33,958,324.52€**

**Janë bërë 2 kërkesa për shitje të automjetit.**

P.Th. Prizren PP/II.nr.2084-9/23

P.Th.Ferizaj PP/II.nr.1176/21.

## 9. SEKUESTRIMET PËR TREMUJORIN E I-rë TË VITIT 2023

| Nr. Rendor | Nr. liProkurorisë  | Vepra penale                                        | Përshkrimi i pasurisë | Prokuroria | Data       |
|------------|--------------------|-----------------------------------------------------|-----------------------|------------|------------|
| 1          | PP/II.nr.506/23    | Legalizim i përmbajtjes së rreme neni 395 i KPRK-së | Automjet              | P.Th.Pejë  | 20.07.2023 |
| 2          | PPN/II.nr.184/2024 | Legalizim i përmbajtjes së rreme neni 395 i KPRK-së | Automjet              | P.Th.Pejë  | 14.03.2024 |

|    |                    |                                                                                                                                        |                        |                |            |
|----|--------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------|----------------|------------|
| 3  | PPN/II.nr.120/2024 | Legalizim i përmbajtjes së rreme neni 395 i KPRK-së                                                                                    | Automjet               | P.Th.Pejë      | 12.02.2024 |
| 4  | PP/II.nr.46/2024   | Vjedhje pylli neni 349 par 1 të KPRK-së                                                                                                | Masë drunore           | P.Th.Pejë      | 18.01.2024 |
| 5  | PPN/II.nr.983/23   | Legalizim i përmbajtjes së rreme neni 395 i KPRK-së                                                                                    | Automjet               | P.Th.Pejë      | 29.12.2023 |
| 6  | PP/II.nr.512/24    | Vjedhje pylli neni 349 par 3 të KPRK-së                                                                                                | Masë drunore           | P.Th.Pejë      | 29.03.2024 |
| 7  | PP/II.nr.469/24    | Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit neni 338 par 1 te KPRK-se                                                                 | Eskavataor, Separacion | P.Th.Pejë      | 29.03.2024 |
| 8  | PPN/II.nr.7/24     | Legalizim i përmbajtjes së rreme neni 395 i KPRK-së                                                                                    | Automjet               | P.Th.Pejë      | 05.01.2024 |
| 9  | PPN/I.nr.68/2024   | Shpërlarje e parasë neni 302 I KPRK-së                                                                                                 | Para Automjet          | P.Th.Pejë      | 08.02.2024 |
| 10 | PP/I.nr.19/24      | Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paaautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1,2 të KPRK-së | Automjet Para          | P.Th.Pejë      | 08.03.2024 |
| 11 | PP/II.nr.165/24    | Shmangie nga pagesa e tarifave te detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par 5 lidhur me par 1 të KPRK-së             | Para                   | P.Th.Ferizaj   | 15.03.2024 |
| 12 | PP/II.nr.974/22    | Shmangie nga pagesa e tarifave te detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par 5 lidhur me par 1 të KPRK-së             | Para                   | P.Th.Ferizaj   | 29.01.2024 |
| 13 | PP/II.nr.281/24    | Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së                                                                                       | Automjet               | P.Th.Ferizaj   | 07.03.2024 |
| 14 | PP/II.nr.1884/23   | Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së                                                                                       | Mjaltë                 | P.Th.Ferizaj   | 30.01.2024 |
| 15 | PPN/II.nr.36/2024  | Falsifikim i dokumenteve 390 i KPRK-së                                                                                                 | Automjet               | P.Th.Gjakovë   | 07.02.2024 |
| 16 | PPN/II.nr.04/2024  | Falsifikim i dokumenteve 390 i KPRK-së                                                                                                 | Automjet               | P.Th.Gjakovë   | 10.01.2024 |
| 17 | PP/I.nr.03/2024    | Vrasje e rëndë në tentativë neni 173 i KPRK-së                                                                                         | Automjet               | P.Th.Gjakovë   | 15.01.2024 |
| 18 | PPN/II.nr.682/23   | Falsifikim i dokumenteve 390 i KPRK-së                                                                                                 | Automjet               | P.Th.Gjakovë   | 04.01.2024 |
| 19 | PPN/II.nr.603/23   | Falsifikim i dokumenteve 390 i KPRK-së                                                                                                 | Automjet               | P.Th.Gjakovë   | 16.11.2023 |
| 20 | PP/II.nr.192/2024  | Vjedhje neni 315 i KPRK-së                                                                                                             | Automjet               | P.Th.Gjakovë   | 20.02.2024 |
| 21 | PP/I.nr.6/24       | Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paaautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1,2 të KPRK-së | Automjet               | P.Th.Mitrovicë | 25.01.2024 |
| 22 | PP/II.nr.559/24    | Shpërdorim i pasurisë së huaj neni 318 par 5 i KPRK-së                                                                                 | Para                   | P.Th.Mitrovicë | 29.03.2024 |
| 23 | PPN/II.nr.121/24   | Vjedhje e rëndë neni 315 par 1 i KPRK-së                                                                                               | Automjet               | P.Th.Mitrovicë | 11.03.2024 |
| 24 | PP/II.nr.370/24    | Vjedhje e rëndë neni 315 par 1 i KPRK-së                                                                                               | Automjet               | P.Th.Mitrovicë | 13.03.2024 |
| 25 | PP/II.nr.70/24     | Falsifikim i dokumenteve 390 i KPRK-së                                                                                                 | Automjet               | P.Th.Mitrovicë | 23.01.2024 |
| 26 | PP/II.nr.346/24    | Tregti e ndaluar 299 të KPRK-së                                                                                                        | Automjet               | P.Th.Mitrovicë | 07.03.2024 |
| 27 | PP/II.nr.46/2024   | Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së                                | Pajisje teknologjike   | P.Th.Mitrovicë | 01.02.2024 |
| 28 | PP/II.nr.161/24    | Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm nga neni 294 par 2 lidhur me par 1 të KPRK-së                                | Pajisje teknologjike   | P.Th.Mitrovicë | 01.02.2024 |

|    |                       |                                                                                                                                       |                       |                |            |
|----|-----------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|----------------|------------|
| 29 | PPP/II.2212/23        | Shmangie nga pagesa e tarifave te detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par 5 lidhur me par 1 të KPRK-së            | Cigare                | P.Th.Mitrovicë | 10.01.2024 |
| 30 | PP/II.2177/23         | Shmangie nga pagesa e tarifave te detyrueshme doganore ose tarifave akcizore nga neni 312 par 5 lidhur me par 1 të KPRK-së            | Cigare                | P.Th.Mitrovicë | 11.01.2024 |
| 31 | PPP/II.nr.223/24      | Falsifikim i dokumenteve 390 i KPRK-së                                                                                                | Automjet              | P.Th.Mitrovicë | 21.03.2024 |
| 32 | PP/II.nr.458/24       | Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së                                                                                      | Pajisje mjekësore     | P.Th.Mitrovicë | 22.03.2024 |
| 33 | PPP/II.861/23         | Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së                                                                                      | Para                  | P.Th.Mitrovicë | 25.01.2024 |
| 34 | PP/I.nr.1/24          | Vrasje në tentativë neni 172 lidhur me nenin 28 të KPRK-së                                                                            | Automjet              | P.Th.Prizren   | 10.01.2024 |
| 35 | PP/I.nr.95/23         | Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1,2 të KPRK-së | Automjet<br>Para      | P.Th.Prizren   | 15.01.2024 |
| 36 | PP/II.nr.1901-15/2023 | Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit neni 338 par 1 te KPRK-se                                                                | Automjet              | P.Th.Prizren   | 12.10.2023 |
| 37 | PPN/II.nr.92-4/24     | Falsifikim i dokumenteve 390 i KPRK-së                                                                                                | Automjet              | P.Th.Prizren   | 02.02.2024 |
| 38 | PP/II.nr.472-1/22     | Falsifikim i dokumenteve 390 i KPRK-së                                                                                                | Automjet              | P.Th.Prizren   | 02.02.2024 |
| 39 | PP/II.nr.2084-9/23    | Falsifikim i dokumenteve 390 i KPRK-së                                                                                                | Automjet              | P.Th.Prizren   | 26.01.2024 |
| 40 | PP/I.nr.217/2023      | Fajde neni 331 par 3 lidhur me par 1 të KPRK-së                                                                                       | Para                  | P.Th.Gjilan    | 27.02.2024 |
| 41 | PPN/II.nr.21/2024     | Falsifikim i dokumenteve 390 i KPRK-së                                                                                                | Automjet              | P.Th.Gjilan    | 15.01.2024 |
| 42 | PPN/II.nr.132/2024    | Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale neni 333 të KPRK-së                                   | Automjet              | P.Th.Gjilan    | 07.03.2024 |
| 43 | PP/II.nr.410/2024     | Tregti e ndaluar 299 të KPRK-së                                                                                                       | Duhan                 | P.Th.Gjilan    | 20.03.2024 |
| 44 | PP/II.nr.290/2024     | Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së                                                                                      | Masë drunore          | P.Th.Gjilan    | 05.03.2024 |
| 45 | PPN/II.nr.135/2024    | Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së                                                                                      | Masë drunore          | P.Th.Gjilan    | 08.03.2024 |
| 46 | PP/II.nr.136/2024     | Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së                                                                                      | Drunj                 | P.Th.Gjilan    | 07.03.2024 |
| 47 | PP/II.nr.231/2024     | Tregti e ndaluar 299 të KPRK-së                                                                                                       | Veshëmbathje          | P.Th.Gjilan    | 15.02.2024 |
| 48 | PP/II.nr.405/2024     | Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së                                                                                      | Mallra                | P.Th.Gjilan    | 22.03.2024 |
| 49 | PP/II.nr.112/2024     | Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së                                                                                      | Automjet<br>Cigare    | P.Th.Gjilan    | 26.01.2024 |
| 50 | PP/II.nr.276/2024     | Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së                                                                                      | Automjet<br>Cigare    | P.Th.Gjilan    | 01.03.2024 |
| 51 | PP/II.nr.433/2024     | Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së                                                                                      | Artikuj shtëpiak      | P.Th.Gjilan    | 25.03.2024 |
| 52 | PP/II.nr.194/2024     | Kontrabandim me mallra neni 311 par 1 të KPRK-së                                                                                      | Suplimente - Proteina | P.Th.Gjilan    |            |
| 53 | PP/I.nr.35/24         | Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1,2 të KPRK-së | Para                  | P.Th.Prishtinë | 20.02.2024 |

|    |                    |                                                                                                                                                                                                                       |                                           |                |            |
|----|--------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------|----------------|------------|
| 54 | PP/I.nr.14/24      | Rrëmbim neni 191 par 2 pika 2.3 lidhur me par 1 të KPRK-së, Lëndim i lehtë trupor neni 185 par 2 të KPRK-së, Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve neni 366 të KPRK-së                   | Automjet                                  | P.Th.Prishtinë | 23.01.2024 |
| 55 | PP/II.nr.932/24    | Rrezikim i trafikut publik neni 370 par 9 lidhur me par 6 të KPRK-së                                                                                                                                                  | Automjet                                  | P.Th.Prishtinë | 01.03.2024 |
| 56 | RN/II.nr.276/2024  | Falsifikim i dokumenteve 390 i KPRK-së                                                                                                                                                                                | Automjet                                  | P.Th.Prishtinë | 29.02.2024 |
| 57 | RN.II.366/24       | Falsifikim i dokumenteve 390 i KPRK-së                                                                                                                                                                                | Automjet                                  | P.Th.Prishtinë | 31.03.2024 |
| 58 | RN.II.nr.1548/2023 | Mashtrim neni 232 par 1 të KPRK-së                                                                                                                                                                                    | Automjet                                  | P.Th.Prishtinë | 04.01.2024 |
| 59 | NJN.nr.36/2023     | Trafikim të paligjshëm të lëndëve narkotike në grup dhe në sasi të mëdha neni 29 par 1 artikulli 1 nr 1 i Kodit Penal për lëndë narkotike BtMG të dënueshme në bazë të nenit 30 a par 1 i Kodit penal gjerman (StBG). | 1 shtëpi, 3 apartamente, 1 garazh Parcela | PSRK           | 26.03.2024 |
| 60 | PPS.nr.99/2021     | Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, sanksionuar nga neni 414 par 2 lidhur me nenin 31 të KPRK-së                                                                                                            | Parcela                                   | PSRK           | 12.02.2024 |
| 61 | PPS.nr.31/2024     | Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve të përfituara me kryerjen e veprës penale neni 333 i KPRK-së, Falsifikim i parasë neni 296 i KPRK-së, dhe Shpëlarje e parave neni 302 i Kodit nr. 06/L-74 i KPRK-së             | Automjet                                  | PSRK           | 16.02.2024 |
| 62 | NJN.nr.37/2023     | Shpëlarja e parave në kundërshtim me nenin 302 të KPRK-së lidhur me veprën penale Mashtrim neni 323                                                                                                                   | Ngrirje e xhirollogarisë                  | PSRK           | 27.03.2024 |
| 63 | PPS.nr.31/2023     | Hyrje në sistemet kompjuterike neni 327 i KPRK-së, Mashtrim neni 323 i KPRK-së, Shpëlarje e parave neni 302 i KPRK-së, Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve neni 366 par 1 i KPRK-së      | Automjete Para                            | PSRK           | 27.02.2024 |

#### 10. KONFISKIMET PËR TREMUJORIN E I-rë TË VITIT 2024

| Nr. I Gjykatës  | Nr. i Prokurorisë | Vepra penale                                                                                                                          | Përshkrimi i pasurisë | Prokuroria     | Data       |
|-----------------|-------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------|----------------|------------|
| 2021:028010     | PP/I.nr.69/2021   | Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge neni 267 par 1,2 të KPRK-së | Para                  | P.Th.Mitrovicë | 14.01.2022 |
| Pml.nr.449/2023 | PP.II.nr.8885/14  | Legalizim i përmbajtjes së rreme neni 403 par 2 i KPRK-së                                                                             | Parcelë               | P.Th.Prishtinë | 16.06.2022 |

## 11. Sekuestrimet vs veprat penale

- 4 automjete, para: **Blerja, posedimi, shpërndarja e paaautorizuar e narkotikëve, substancave psikotrope dhe analoge;**
- 3 automjete janë sekuestruar nga vepra penale: **Blerja, pranimi ose fshehja e sendeve te perfituara me kryerjen e veprës penale;**
- Para janë sekuestruar nga vepra penale: **Fajde;**
- 12 automjete janë sekuestruar nga vepra penale: **Falsifikim i dokumentit;**
- 8 automjete janë sekuestruar nga vepra penale: **Hyrje në sistemet kompjuterike, Shpëlarje e parave;**
- 1 automjet është sekuestruar nga vepra penale: **Shpëlarje e parave;**
- 4 parcela janë sekuestruar nga vepra penale: **Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar;**
- 3 automjete, para, artikuj shtëpiak, masë drunore, pajisje mjekësore janë sekuestruar nga vepra penale: **Kontrabandim me mallra;**
- 5 automjete, janë sekuestruar nga vepra penale: **Legalizim i përmbajtjes së rreme;**
- 1 automjet është sekuestruar nga vepra penale: **Mashtrim;**
- 1 automjet, 1 eskavator, 1 separacion janë sekuestruar nga vepra penale: **Ndotja, degradimi ose shkatërrimi i mjedisit;**
- Pajisje teknologjike janë sekuestruar nga vepra penale: **Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm;**
- 1 automjet është sekuestruar nga vepra penale: **Rrëmbim**
- 1 automjet është sekuestruar nga vepra penale: **Rrezikim i trafikut publik;**
- Para, cigare janë sekuestruar nga vepra penale: **Shmangie nga pagesa e tarifave të detyrueshme doganore ose tarifave akcizore;**
- Para janë sekuestruar nga vepra penale: **Shpërdorim i pasurisë së huaj;**
- Para janë sekuestruar nga vepra penale: **Shpëlarja e parave;**
- 1 shtëpi, 3 apartamente, 1 garazhë janë sekuestruar nga vepra penale: **Trafikim të paligjshëm të lëndëve narkotike në grup dhe në sasi të mëdha;**
- 2 automjete, veshëmbathje, duhan janë sekuestruar nga vepra penale: **Tregti e ndaluar;**

- **1** automjet është sekuestruar nga vepra penale: **Vjedhje**;
- **3** automjete janë sekuestruar nga vepra penale: **Vjedhje e rëndë**;
- **Masë drunore** është sekuestruar nga vepra penale: **Vjedhje pylli**
- **2** automjete janë sekuestruar nga vepra penale: **Vrasje e rëndë në tentativë**;

## **12. Sekuestrimet vs prokuroritë**

- 1. Prokuroria Speciale** ka sekuestruar: **10** automjete, para, 12 parcela, 1 shtëpi, 3 apartamente, 1 garazhë;
- 2. P. Th. Pejë** ka të sekuestruar: **7** automjete, **1** eskavator, **1** separacion, para, masë drunore;
- 4. P. Th. Prishtinë** ka të sekuestruar: **5** automjete, para;
- 5. P. Th. Mitrovicë** ka të sekuestruar: **8** automjete, para, pajisje teknologjike, pajisje mjekësore, cigare;
- 6. P. Th. Ferizaj** ka sekuestruar: **1** automjet, para;
- 7.P. Th. Gjilan** ka sekuestruar **4** automjete, para, masë drunore, duhan, mallra, veshëmbathje;
- 8.P. Th. Gjakovë** ka sekuestruar **6** automjete;
- 9.P. Th. Prizren,** ka sekuestruar **7** automjete, para.

### **13. LISTAT E PROKURORËVE**

Në vijim është lista e prokurorëve që kanë zbatuar urdhëresa për sekuestrim dhe konfiskim për Tremujorin e I-rë, 2024 të cilët janë:

**63 raste – sekuestreime,**

**2 raste - konfiskim**

**PTH Ferizaj ka pasur 3 raste**

Ardian Emini 1 rast  
Mimoza Syla 1 rast  
Fatos Ajvazi 1 rast

**PTH Prizren ka pasur 6 raste**

Mehdi Sefa 1 rast  
Petrir Kryeziu 1 rast  
Merita Kurtishi Gaka 1 rast  
Elfete Purova 1 rast  
Muharrem Hoxha 1 rast  
Shpend Binaj 1 rast

**PTH Pejë, ka pasur 10 raste**

Ardiana Veseli 2 raste  
Lumturie Hoxha 1 rast  
Arlinda Nallbani Gacaferri 4 raste  
Lumturie Vuqetaj 2 raste  
Ramiz Buzhala 1 rast

**PTH Gjilan ka pasur 13 raste**

Kujtesa Fazliu 1 rast  
Leonora Kadriu 3 raste  
Rozelida Manastiri 3 raste  
Agron Uka 1 rast  
Huma Jetishi 5 raste

**PTH Mitrovicë 13 raste**

Albana Parduzi 8 raste  
Ajtene Zoni 4 raste  
Sahit Tmava 1 rast  
Njazi Rexha 1 rast **konfiskim**

**PTH Prishtinë ka pasur 6 raste**

Eseta Rama 2 raste  
Besart Mustafa 1 rast  
Besnik Jakupi 1 rast  
Arben Hoti 1 rast  
Bashkim Zeqaj 1 rast  
Rukije Shasivari 1 rast **konfiskim**

**PTH Gjakovë ka pasur 6 raste**

Deshire Jusaj 1 rast  
Qazim Xharra 2 raste  
Qazim Kuqi 1 rast  
Kastriot Memaj 2

**PSRK ka pasur 5 raste**

Habibe Salihu 2 raste  
Merita Bina Rugova 1 rast  
Iliriana Qollaku Tafa 1 rast  
Milot Krasniqi 1 rast

#### 14. KALLËZIME PENALE (PP) TË KRIMEVE EKONOMIKE

Prokuroritë, në tre mujorin e parë të vitit 2024, kishin **430** raste të pazgjidhura me **607** persona të përfshirë në veprat penale të krimeve ekonomike; kanë pranuar **77** kallëzime penale të reja me **87** persona. Nga këto të dhëna rezulton, prokuroritë kishin në punë gjithsej **507** kallëzime penale me **694** persona. Kanë zgjidhur **73** raste me **105** persona këtë tremujor dhe në fund kanë mbetur **434** kallëzime penale me **589** persona të pazgjidhura (*shih figura 1*).

| PROKURORIA |           | Raste të pazgjidhura në fillim (persona) |            | Rastet e pranuar të reja (përfshirë edhe ndarjen e procedurës) (persona) |           | Gjithsej raste në punë (persona) |            | Raste të zgjidhura (persona) |            | Raste të pazgjidhura në fund (persona) |            |
|------------|-----------|------------------------------------------|------------|--------------------------------------------------------------------------|-----------|----------------------------------|------------|------------------------------|------------|----------------------------------------|------------|
|            |           | A                                        |            | B                                                                        |           | D (A+B+C)                        |            | E                            |            | F(D-E)                                 |            |
|            |           | R                                        | P          | R                                                                        | P         | R                                | P          | R                            | P          | R                                      | P          |
| 1          | SPECIALE  |                                          |            |                                                                          |           |                                  |            |                              |            |                                        |            |
| 2          | PRISHTINË | 233                                      | 285        | 24                                                                       | 24        | 257                              | 309        | 21                           | 21         | 236                                    | 288        |
| 3          | PRIZREN   | 20                                       | 27         | 5                                                                        | 7         | 25                               | 34         | 7                            | 10         | 18                                     | 24         |
| 4          | PEJË      | 37                                       | 57         | 5                                                                        | 5         | 42                               | 62         | 11                           | 23         | 31                                     | 39         |
| 5          | GJILAN    | 3                                        | 5          | 21                                                                       | 23        | 24                               | 28         | 14                           | 17         | 10                                     | 11         |
| 6          | MITROVICË | 89                                       | 142        | 12                                                                       | 14        | 101                              | 156        | 8                            | 12         | 93                                     | 144        |
| 7          | FERIZAJ   | 37                                       | 59         | 6                                                                        | 9         | 43                               | 68         | 8                            | 8          | 35                                     | 60         |
| 8          | GJAKOVË   | 11                                       | 32         | 4                                                                        | 5         | 15                               | 37         | 4                            | 14         | 11                                     | 23         |
| GJITHSEJ:  |           | <b>430</b>                               | <b>607</b> | <b>77</b>                                                                | <b>87</b> | <b>507</b>                       | <b>694</b> | <b>73</b>                    | <b>105</b> | <b>434</b>                             | <b>589</b> |

Figura 1

Numri i lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve në punë (të bartura dhe të pranuara), rezulton:

- Nga **507** kallëzime penale në PUNË janë zgjidhur **73**, apo 14.39 %.
- Nga **694** persona në PUNË janë zgjidhur **105** apo 15.12 %.

Numri i lëndëve të zgjidhura në raport me numrin e lëndëve të pranuara të reja, rezulton:

- Nga **77** lëndë të pranuara të reja të PRANUARA janë zgjidhur **73**, apo 94.80 %.
- Nga **87** rastet me persona të reja të PRANUARA janë zgjidhur **105** apo 120.68 %.

## 15. MËNYRA E ZGJIDHJES SË RASTEVE PËR PERSONA

Gjatë tre mujorit të parë 2024, prokuroritë kanë proceduar (zgjidhur/kryer) rastet e **83** personave të përfshirë në veprat penale të grupit të krimeve ekonomike (shih figurën 2), respektivisht:

- Për **12** persona janë hedhur kallëzimet penale;
- Për **10** persona janë pushuar hetimet;
- Për **83** persona janë ngritur aktakuza.

| MËNYRA E ZGJIDHJES<br>SË PERSONAVE “PP” - ”<br>TË KRIMEVE<br>EKONOMIKE |                  | Gjithsej   | Është<br>hedhur<br>kallëzimi<br>penal | Masat<br>për<br>trajtimin<br>psikiatrik | Është Pushuar<br>Hetimi | AKTAKUZË                                        |                  |                                  | Mënyre<br>tjetër<br>(është<br>bashkuar<br>procedura<br>) |
|------------------------------------------------------------------------|------------------|------------|---------------------------------------|-----------------------------------------|-------------------------|-------------------------------------------------|------------------|----------------------------------|----------------------------------------------------------|
|                                                                        |                  |            |                                       |                                         |                         | Për dhënien e<br>urdhrit<br>ndëshkimor          | E drejtpërdrejtë | Pas<br>zhvillimit të<br>hetimeve |                                                          |
| 1                                                                      | PSRK             |            |                                       |                                         |                         |                                                 |                  |                                  |                                                          |
| 2                                                                      | P. Th. Prishtinë | <b>21</b>  | 4                                     |                                         | 4                       |                                                 | 1                | 12                               |                                                          |
| 3                                                                      | P. Th. Prizren   | <b>10</b>  | 2                                     |                                         | 1                       |                                                 |                  | 7                                |                                                          |
